



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 16 maj 2022

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Mjedis i pastër, shëndet dhe edukim cilësor në shkollat e Paskuqanit*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon prodhimin e 400 bluzave të loguara, 1 baner dhe 1 tabelë investimi,

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 16 maj 2022, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Sasia	Çmimi/njësi Me TVSH
1	Bluza të loguara	400	
2	Baner	1	
3	Tabelë investimi	1	

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Bluzë me mëngë të shkurtra, Masa S, M, L; Material pambuk 140-180 g/m²; Print logot dhe mesazhi ne format A4; ngjyrë e bardhë, ngjyrat e stampimit 4 color.
- Baner, material i plastifikuar, me përmasa 85 cm gjerësi dhe 200 cm gjatësi, printim me katër ngjyra, përfshirë titullin e projektit, periudha kohore dhe 5 logo.
- Tabela e investimit, material forex, me bisht metalik per tu ngulur ne toke, në format 40 x 40 cm, ngjyrat e stampimit 4 color

Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **19 Maj-30 Tetor 2022**. Me Subjektin fitues do të lidhet një kontratë.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Kamëz
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës office@milieukontakt.org brenda datës 16 maj 2022 ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.
Nuk pranohen ofertat dorazi.
- 4) Paguesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB të marrë deri një ditë para postimit të ofertës;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.